



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE**

RREGULLORE

PËR

**ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E TESTIMIT TË NJOHURIVE TË
KANDIDATËVE QË APLIKOJNË PËR LICENCË/RINOVIM LICENCE NË
AUTORITETIN E MBIKËQYRJES FINANCIARE**

Miratuar me Vendimin e Bordit nr.35, datë 27.03.2019

Neni 1

Baza ligjore

Bazë ligjore për këtë rregullore janë:

1. Ligji nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, neni 209, pika 2; neni 222, pika 3, shkronja “ç”; neni 227, pika 1, shkronja “dh”, pika 2.
2. Ligji nr. 9879, datë 21.02.2008 “Për titujt”, nenet 58 dhe 59.
3. Ligji nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, neni 14, pika 2.

Neni 2

Objekti dhe qëllimi

Kjo rregullore përcakton mënyrën dhe procedurën për kryerjen e testimit të njohurive për licencim nga:

1. Kandidatët që kanë plotësuar kriteret dhe aplikojnë në Autoritet për t’u pajisur me licencë;
2. Kandidatët që kanë plotësuar kriteret dhe aplikojnë në Autoritet për të rinovuar licencën.

Neni 3

Përkufizime

Në këtë rregullore termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Autoritet” nënkupton Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare.
2. “Testim” nënkupton kontrollin e njohurive ligjore, kodet/rregullat etike, njohuritë dhe standardet profesionale për ushtrimin e veprimtarisë për të cilën aplikohet pranë Autoritetit për t`u licencuar ose për të rinovuar licencën.
3. “Kandidat” është personi i cili ka plotësuar kriteret dhe kushtet për t`u regjistruar në testim.
4. “Vendi i testimit” është në selinë e Autoritetit ose në një vend tjetër të përcaktuar nga Autoriteti.

Neni 4

Fusha e zbatimit dhe personat që testohen

Kjo rregullore zbatohet për testimin e njohurive të:

1. Personave fizikë të cilët aplikojnë për t`u pajisur me licencë për:
 - i. Vlerësues dëmsh në sigurime;
 - ii. Broker në sigurime;
 - iii. Broker në tituj;
 - iv. Këshilltar investimesh;
 - v. Aktuar i autorizuar.
2. Personave fizikë të cilët aplikojnë për të rinovuar licencën për:
 - i. Vlerësues dëmsh në sigurime.

Neni 5

Testimi

1. Me qëllim realizimin e testimit të njohurive sistemi i pyetjeve është i kompozuar si vijon:
 - Me alternativa (zgjedhje e një apo më shumë alternativave, e vërtetë/e gabuar);
 - Me përshkrim (narrative/shpjeguese);
 - Me kazuse (ushtrime me zgjidhje/komente).
2. Pyetjet janë në varësi të veprimtarisë për të cilën aplikohet për t`u pajisur me licencë ose rinovimi i saj.

3. Pyetjet përfshijnë njohuri mbi ligjet, aktet nënligjore (rregulloret, udhëzimet, manualet), kodet/rregullat etike, njohuritë dhe standardet profesionale.
4. Testimi duhet të përmbajë në mënyrë të qartë: numrin total të pikëve, kufirin minimal të pikëve për t'u kualifikuar "kalues", por në çdo rast nuk mund të jetë më i ulët se 60 % e totalit, datën dhe orën e fillimit të testimit, kohën në dispozicion për testimin e njohurive dhe shpjegime të tjera që konsiderohen të nevojshme si instruksione për kandidatët.

Neni 6

Komisioni i testimit

1. Komisioni i testimit për krijimin e tezës me pyetje përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë nga të cilët: 3 (tre) janë punonjës të Autoritetit; 2 (dy) ekspertë të jashtëm që mund të jenë profesionistë në fushën për të cilën do të organizohet testimi i njohurive apo specialistë nga fusha akademike.
2. Komisioni i testimit përcaktohet me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv.
3. Komisioni i Testimit është përgjegjës për procedurën e testimit, ku përfshihet organizimi i testimit, hartimi i pyetjeve, korrigjimi i testeve dhe nxjerrja e rezultateve.
4. Ekspertët e jashtëm të komisionit të testimit marrin pagesë sipas tarifave të përcaktuara në aktet nënligjore në fuqi në shërbimin civil.

Neni 7

Regjistrimi dhe pranimi në testim

1. Personat që plotësojnë kriteret dhe kërkesat e parashikuara në ligj dhe aktet nënligjore të Autoritetit, kalojnë në fazën e testimit të njohurive për pajisje ose rinovim të licencës.
2. Lista e personave që do t'i nënshtrohen testimit të njohurive publikohet në faqen zyrtare të Autoritetit jo më vonë se 7 (shtatë) ditë kalendarike nga data e zhvillimit të testimit.
3. Njoftimi për zhvillimin e testimit të njohurive publikohet në faqen zyrtare të Autoritetit eëë.amf.gov.al, 30 (tridhjetë) ditë kalendarike para datës së zhvillimit të testimit. Njoftimi përmban: vendin, datën dhe orën e testimit.

Neni 8

Organizimi i testimit

1. Testimi për njohuritë organizohet nga Autoriteti.
2. Si rregull testimi organizohet minimalisht 2 (dy) herë në vit për secilin profesion. Ky rregull nuk zbatohet kur nuk ka kërkesa për licencim apo rinovim licence.
3. Për paraqitjen në vendin e testimit kandidatët duhet të kenë parasysh rregullat e mëposhtme:
 - a. të jenë të pajisur me dokumentin e identifikimit (ID, pasaportë etj.);
 - b. të paraqiten së paku 30 minuta përpara fillimit të testimit;

- c. të jenë të pajisur me mjetet e nevojshme për zhvillimin e testimit (makinë llogaritëse, stilolaps etj.);
4. Kandidatët nuk lejohet të kontaktojnë me kandidatët e tjerë gjatë testimit, nuk lejohet të përdorin celularët dhe mjetet e të tjera të komunikimit gjatë zhvillimit të testimit. Nëse konstatohen sa më sipër, kandidati automatikisht është i skualifikuar.
5. Regjistrohen të dhënat paraprake për secilin kandidat sipas dokumentit të identifikimit.
6. Kandidatët nënshkruajnë deklaratën tip, formati i të cilës, është bashkëlidhur me këtë rregullore.
7. Rregullat e testimit përcaktohen në urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv.
8. Rezultatet e testimit i dërgohen me e-mail, individualisht secilit kandidat.
9. Autoriteti mban një bazë të dhënash për të gjitha testimet e kryera.

Neni 9

Mbikëqyrja e procesit të testimit

1. Procesi i testimit mbikëqyret nga një ose më shumë punonjës të Autoritetit, në varësi të numrit të kandidatëve që do të nënshtrohen testimit, të cilët:
 - a. janë përgjegjës për mbarëvajtjen e testimit sipas rregullave të caktuara në këtë rregullore;
 - b. mbajnë qetësinë gjatë zhvillimit të testimit.
2. Mbikëqyrësit e testimit janë persona jo të profesionit të kandidatëve që po testohen dhe nuk janë anëtarë të komisionit të testimit të njohurive. Në urdhrin e DPE për testimin që do të zhvillohet, përcaktohen edhe mbikëqyrësit e testimit.

Neni 10

Tërheqja nga testimi

1. Nëse një kandidat nuk paraqitet në testim ose tërhiqet përpara fillimit të tij, atëherë testimi nuk vlerësohet si i kryer.
2. Tërheqja nga testimi nuk lejohet pas hyrjes në sallën e testimit.
3. Kur kandidati tërhiqet nga testimi pasi ka hyrë në sallën e testimit, testi konsiderohet i kryer dhe vlerësohet jokalues.

Neni 11

E drejta e ankimit

1. Kandidati ka të drejtën e ankimit.
2. Kandidati paraqet ankesën me shkrim, pranë Autoritetit brenda 5 (pesë) ditë pune nga data e publikimit të rezultateve.
3. Për shqyrtimin e ankesës, Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i Autoritetit ngre komision të posaçëm.

4. Pas mbarimit të procedurës së ankimit, rezultati i dërgohet me e-mail, ankuesit.

Neni 12

Komisioni i shqyrtimit të ankesave

1. Komisioni i shqyrtimit të ankesave ngrihet rast pas rasti dhe është përgjegjës për procedurën e rikorigjimit të testit.
2. Komisioni i shqyrtimit të ankesave përcaktohet me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv.
3. Përbërja e komisionit të shqyrtimit të ankesave duhet të jetë e ndryshme nga ajo e komisionit të testimit.
4. Komisioni i shqyrtimit të ankesave shqyrton ankesat, harton raportin për Drejtorin e Përgjithshëm Ekzekutiv dhe përgatit përgjigjen brenda 10 (dhjetë) ditë pune nga data e depozitimit të ankesës.
5. Komisioni i shqyrtimit të ankesave përbëhet nga 3 anëtarë nga të cilët: 2 (dy) janë punonjës të Autoritetit dhe 1 (një) ekspert i jashtëm që mund të jetë profesionist në fushën për të cilën bëhet ankesa apo specialist nga fusha akademike.
6. Ekspertët e jashtëm të komisionit të shqyrtimit të ankesave marrin pagesë sipas tarifave të përcaktuara në aktet nënligjore në fuqi në shërbimin civil.

Neni 13

Përsëritja e testimit

Subjektet e përcaktuara në nenin 4 të kësaj Rregullore, nëse marrin vlerësim negativ në testim, kanë të drejtën e ritestimit deri në 4 herë.

Neni 14

Ruajtja dhe asgjësimi i dokumentacionit lidhur me procedurat e testimit

1. Dokumentacioni që është krijuar gjatë procesit të testimit, dorëzohet dhe ruhet në protokollin/arkivën e Autoritetit në përputhje me legjislacionin në fuqi, me përjashtim të fletëve të testeve dhe ritestimeve të kandidatëve pjesëmarrës, të cilat ruhen jo më shumë se 3 (tre) muaj nga data e dhënies së testimit ose/dhe ritestimit.
2. Asgjësimi i tyre kryhet nga një komision prej 3 anëtarësh, i ngritur nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i Autoritetit.

Neni 15
Shfuqizime

1. Shfuqizohet kreu III “Testimi i Njohurive” (nenet 11, 12, 13) i Rregullores nr. 85, datë 03.07.2017 “Mbi licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së vlerësuesit të dëmeve në sigurime”.
2. Shfuqizohen neni 5 dhe neni 6 i Rregullores nr. 48, datë 30.06.2015 “Për kriteret, procedurat dhe afatet e licencimit si dhe rastet e refuzimit të licencës për të ushtruar veprimtari brokerimi në sigurime”, e ndryshuar.

Neni 16
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.

DEKLARATË

Unë i/e nënshkruari/a, me vullnetin tim të lirë e të plotë, në dijeni të plotë të pasojave që sjell një deklaram i pavërtetë, nën përgjegjësinë time personale deklaroj se:

- Jam i vetëdijshëm se **Testi i njohurive në _____**, **nuk nënkupton licencimin tim si _____**. Për t'u licencuar si _____ duhet të përmbush të gjitha kërkesat e rregullores nr. _____ datë _____. _____ licencohen nga Autoriteti me vendim Bordi.
- Nuk jam angazhuar dhe nuk do të angazhohem në ndonjë sjellje që komprometon integritetin, vlefshmërinë dhe sigurinë e testit që po organizohet sot, në datë _____ mbitestimineaftësi vetëmi profesionale në _____.
- Jam i vetëdijshëm se **Testi i njohurive në _____** është pronë e Autoritetit, dhe se duke marrë pjesë në këtë test zotohem se nuk do të nxjerr pyetjet e testit jashtë dhomës së testimit.
- I lexova të gjitha kushtet dhe instruksionet e këtij testimi dhe shprehem dakord

Data e nënshkrimit _____

FIRMA _____